



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 5, neni 6 paragrafi 1.1 dhe neni 14 pika 3 i Ligjit për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale (Ligji nr. 06/L-092), neni 4 dhe 8 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Neni 32 i Statutit të komunës së Dragashit 01Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, propozimit të kryetarit të Komunës, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak kuvendi i Komunës së Dragashit në Seancën e mbajtur më 31.01.2024 miraton këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PATUNDSHMËRISË KOMUNALE

Neni 1

Jepet në shfrytëzim afatshkurtër lokali afaristë i cili është në pronësi të komunës, deri tash o njohur si bife përballë Hotelit "MEKA" në kuadër të ndërtesës në ngastrën kadastrale O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash Rr. "13 Ushtarët" 10 P 3 1, me sipërfaqe 60.98 m².

Neni 2

Afati i shfrytëzimit të pronës – lokalit të lartcekur është 5 (pesë) vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës, gjenerimi i të ardhurave si dhe qëllimi i qytetarëve që të vetëpunësohen.

Neni 4

Procedura për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për dhënie afatshkurtër në shfrytëzim do të jepet nëpërmjet ankandit publik nga komisioni vlerësues, ku do të caktohen kushtet për aplikim, çmimi fillestar etj.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesit të ardhshëm të lokalit afarist do të caktohen me marrëveshjen e cila do të lidhet, duke pas parasysh legjislacionin në fuqi (ligjet financiare, tatimore etj.).

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues dhe sipas nevojës edhe autoriteti kompetent.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore)- Prishtinë,
- Komisioni për vlerësim, të gjithë anëtarëve,
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-2095-7/25

Dt. 31.01.2025

Kryesuesja e Kuvendit:

Arijeta Skeraj



A. Skeraj